

VENDIM
Nr. 71, datë 12.4.2024

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “WENERG” SHA, PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT TË ERE-s, PËR VENDOSJEN E BARRËS SIGURUESE TË RADHËS SË DYTË MBI AKSIONET E SAJ SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 9, pika 8 dhe nenit 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.4.2024, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 185/4 prot., datë 9.4.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘WEnerg’ sh.a. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e barrës siguruese të radhës së dytë mbi aksionet e saj, si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”, konstatoi se:

- Shoqëria “WEnerg” sh.a. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 51, datë 5.7.2010, si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 137, datë 8.10.2012.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 185 prot., datë 18.1.2024, shoqëria ka paraqitur kërkesën për të marrë autorizimin e ERE-s, për vendosjen e barrës siguruese të radhës së dytë mbi aksionet e shoqërisë “WEnerg” sh.a. nga “YLLIAD” sh.p.k. në favor të CN’AIR, kjo si garanci për pagesën e shtesës së çmimit 1 dhe shtesës së çmimit 2, referuar përcaktimeve të marrëveshjes për shitblerjen e aksioneve të shoqërisë “WEnerg” sh.a., nënshkruar më 1.6.2023, mes “YLLIAD” sh.p.k. dhe “CN’AIR”.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 238, datë 21.12.2020, është vendosur dhënia e autorizimit nga ERE për barrësimin e 100% të aksioneve të shoqërisë “WEnerg” sh.a., në favor të “Bankës OTP Albania” sh.a. (ish-Societe Generale Albania sh.a.).

- Në lidhje me këtë barrësim, shoqëria ka depozituar në ERE deklaratën noteriale të datës 29.3.2024, me anë të së cilës “Banka OTP Albania” sh.a., në cilësinë si barrëmarrëse e radhës së parë mbi aksionet e shoqërisë “WEnerg” sh.a. jep pëlqimin e saj për vendosjen e barrës siguruese të radhës së dytë në favor të CN’AIR, me kushtin që kjo barrë të fshihet në momentin e plotësimit të kushteve të parashikuara në kontratën e cedimit mes palëve.

- Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të depozituar nga shoqëria, me shkresën e ERE-s nr. 185/1 prot., datë 2.2.2024, i është evidentuar shoqërisë informacioni/dokumentacioni i munguar i këtij aplikimi. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 185/2 prot., datë 20.2.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Duke qenë se kishte ende dokumentacion të paplotësuar, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 185/3 prot., datë 13.3.2024. Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 185/4 prot., datë 2.4.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e munguar të aplikimit.

- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të

ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, si dhe rezulton se ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj ERE-s për sa i përket pagesave rregullatore.

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e aksioneve të shoqërisë “WEnerg” sh.a. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

- Për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi aksionet për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi aksionet ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e barrës siguruese të radhës së dytë mbi aksionet e shoqërisë “WEnerg” sh.a. në favor të “CN’AIR”.

2. Dhënia e Autorizimit nga ERE, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, nuk e çliron shoqërinë “WEnerg” sh.a. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria “WEnerg” sh.a. duhet të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi aksionet ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “WEnerg” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi